

EGJS na mëson për
SHËNDETIN



NGRIJE dorën
cilësinë në arsim

**EDUKIMI SEKSUAL
ËSHTË DORË E ZGJATUR
E EDUKIMIT FAMILJAR**



Prindër të dashur,

E dimë që ju jeni hallka më e rëndësishme në zhvillimin e fëmijëve gjatë pubertetit. Si prind, ju jeni të parët që kujdeseni që fëmijët tuaj të bëhen personalitete të shëndosha. Dëshironi t'i ngushëlloni kur janë të mërzitur, t'i inkurajoni ata në kuriozitetin e tyre, t'i ndihmoni kur kanë probleme shëndetësore ose kur krijojnë miqësi dhe marrëdhënie kur nuk u shkon për dore.


Por, përveç familjes, edhe shkolla duhet të luajë gjithashtu një rol pozitiv në zhvillimin e duhur emocional, social dhe seksual të fëmijëve tuaj. Edukimi seksual nuk ka për qëllim të zëvendësojë edukimin familjar, por të plotësojë dhe t'i ndihmojë fëmijët të përgatiten më lehtë për të gjitha sfidat që sjell jeta. Jo gjithmonë fëmijët duan të flasin me prindërit e tyre për tema të ndjeshme që i shqetësojnë kur rriten. Dhe këtu shkolla mund të ndihmojë shumë.

Në shtator të vitit 2021, shkolla juaj do të fillojë zbatimin e një pilot programi për edukimin gjithëpërfshirës seksual. Me këtë broshurë ne dëshirojmë t'ju informojmë se si do të zhvillohet mësimi dhe pse këto tema janë të rëndësishme për zhvillimin e fëmijëve. Gjithashtu, nëse keni ndonjë pyetje ose shqetësim lidhur me edukimin seksual, do të kishim dashur që në fund të broshurës t'i ndanë me ne, me qëllim që mësimi t'u përgjigjet nevojave të fëmijëve tuaj sa më mirë që të mundet.

Me respekt,

Byroja për zhvillimin e arsimit

**HERA – Asociacioni për edukim
shëndetësor dhe hulumtim**




A është i detyrueshëm edukimi seksual për nxënësit?

JO.

Në shkollat, të cilat do ta zbatojnë pilot programin për edukimin gjithëpërfshirës seksual, kjo lëndë nuk është e detyrueshme për nxënësit e klasave të nënta. Lënda është fakultative dhe ju si prind mund të mos e zgjidhni këtë lëndë për fëmijën Tuaj. Nëse vendosni që fëmija juaj të mos e ndjeke mësimin për edukim seksual, megjithatë ju rekomandojmë që të flisni me atë dhe të dëgjoni mendimin e tij. Fëmijët kanë shumë pyetje lidhur me zhvillimin seksual, që do të thotë se ata gjithashtu kanë nevojë për përgjigje. Dhe ndonjëherë është më lehtë për ata që t'i kërkojnë në shkollë.

**DUKE E NJOHUR TRUPIN
TONË KUJDESEMI PËR
SHËNDETIN TONË!**






Kush do të ligjërojë në orët për edukim seksual?

Edukimin seksual do ta ligjërojnë mësime të trajnuar nga shkolla juaj. Mësime të trajnuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e Kombeve të Bashkuara për zbatimin e edukimit gjithëpërfshirës seksual. Temat që do të diskutohen në orët e edukimit seksual bazohen në fakte shkencore dhe janë përshtatur për moshën e fëmijëve (14 vjeç). Mësimi do të zhvillohet përmes diskutimit me nxënësit dhe nuk do të vlerësohet në mënyrë numerike.

**DUKE U INFORMUAR
SOT DERI NË NJË TË NESËRME
TË SIGURT - PËR SHËNDETIN
RIPRODHUES!**



Cilat janë përfitimet për fëmijën time nëse ai mëson edukim seksual?

Në shtetet të cilat kanë edukim seksual cilësor, është vërejtur se fëmijët, në krahasim me bashkëmoshatarët të cilët nuk kanë një edukim të këtillë, kanë një sjellje më të përgjegjshme ndaj shëndetit të tyre. Kështu, zvogëlohen të gjitha llojet e sjelljeve të rrezikshme, siç janë fillimi i hershëm i marrëdhënieve seksuale ose mospërdorimi i mbrojtjes.

Përmes orëve të edukimit seksual, fëmijët i ndërtojnë pikëpamjet e tyre për shumë prej pyetjeve të tyre lidhur me shëndetin seksual dhe riprodhues dhe bëhen më empatikë. Pritet që kjo lëndë do t'ua përmirësojë vetëbesimin dhe aftësitë e tyre të komunikimit.

Sot, edukimi seksual në shkolla është më se i nevojshëm sepse u jep mundësi të rinjve të bisedojnë për çështje që i mundojnë lidhur me seksualitetin - ndryshe nga interneti, ku informacionet janë lehtë të disponueshme, por shpesh të pasakta dhe të dëmshme.

Cilat tema do të mësohen në orët e edukimit seksual?

Edukimi seksual nuk është edukim për seksin. Edukimi seksual është një lloj mbështetje dhe mbrojtje e zhvillimit seksual, social dhe emocional të fëmijëve. Përmes edukimit seksual ne duam që fëmijët:

- Të dinë se çfarë ndryshimesh ndodhin gjatë pubertetit!
- Të dinë se cilat janë simptomat e HIV dhe të infeksioneve seksualisht të transmetueshme!
- Të dinë ku të drejtohen për ndihmë për një problem shëndetësor ose dhunë!
- Të kuptojnë pse duhet të ekzistojë barazi midis femrave dhe meshkujve!
- Të pranojnë dhe ta duan pamjen e trupit të tyre!



RESPEKTI ËSHTË PASQYRË E EDUKIMIT SEKSUAL. ME KOMUNIKIM TË HAPUR PËR NJË MARRËDHËNIE TË SHËNDOSHË!



- Të mund ta njohin dhunën dhe të mbrohen!
- Të dinë të thonë “Jo” nëse nuk duan të kenë marrëdhënie seksuale!
- Të mbrohen nga dhuna e mundshme dhe eksploatimi seksual!
- Të dinë si të krijojnë lidhje të shëndosha si partnerë!
- Të mësojnë për të drejtat e njeriut lidhur me seksualitetin dhe riprodhimin
- T’i respektojnë të gjithë njerëzit pa diskriminuar dhe të luftojnë që edhe ata të respektohen!

Fëmijët nuk duan të dinë fjalë për fjalë gjithçka lidhur me seksualitetin dhe zhvillimin seksual, por ata duan të flasin dhe të marrin përgjigje për ato që u intereson atyre. Kështu ata mësojnë më shumë për veten e tyre, mësojnë se si të përballen më lehtë në situata të caktuara dhe si t’i tejkalojnë vështirësitë me të cilat do të përballen derisa rriten.

**TABU NË TOKËN E ÇUDIRAVE?
NGA FYTYRA E KUQE – RREZATON
VETËBESIMI!**




**Disa prindër thonë: “Fëmijët që kanë edukim seksual, hynë më herët në marrëdhënie seksuale”.
A mendoni nëse kjo është e vërtetë?**

Jo, nuk ka rëndësi. Përkundrazi, fëmijët të cilët kanë orë për edukim seksual, mesatarisht kryejnë marrëdhëniet e para seksuale shumë më vonë sesa ata që nuk kanë mësim të tillë. Dhe e dinë se çfarë do të thotë “Po!” nëse dëshirojnë të kenë lidhje partneriteti ose lidhje intime.

Edukimi seksual i ndihmon të rinjtë të çlirohen nga presioni i mjedisit dhe bashkëmoshatarëve të tyre për të filluar para kohe me marrëdhëniet seksuale. Në vendet si Holanda, Danimarka, Suedia, Norvegjia ose Zvicra, fëmijët të cilët kanë edukim seksual dinë shumë më mirë të mbrohen nga shtatzënia e padëshiruar, infeksionet seksualisht të transmetueshme dhe dhuna në marrëdhënie. Atje lindjet adoleshente janë prej 2 deri 3 herë më pak për dallim nga vendi ynë.





Thonë, edukimi seksual i mëson fëmijët për homoseksualitetin?

Orientimi seksual nuk është i lindur, e as nuk mësohet, por zgjidhet. Edukimi gjithëpërfshirës seksual i mëson fëmijët që t'i respektojnë dallimet mes njerëzve, në mënyrë kritike t'i shqyrtojnë paragjykimet dhe të angazhohen për shoqëri të barabartë për të gjithë. Kështu, ata bëhen pjesë e komunitetit ku nuk tolerohet diskriminimi dhe dhuna mbi asnjë bazë.

**PËRMES RESPEKTIMIT TË
DIVERSITETIT NE NDËRTOJMË
NJË SHOQËRI TË BARABARTË DHE
NJERËZORE PËR TË GJITHË!**




A është edukimi seksual i kundërt me religjionin?


Edukimi seksual nuk ka për qëllim t'i ndryshojë bindjet religjioze të fëmijëve, por t'i ndihmojë ata të rriten në njerëz të përgjegjshëm, empatikë, tolerantë dhe të mirë. Në disa vende me popullsi kryesisht katolike, institucionet fetare gjithnjë e më shumë po mbështesin ndonjë formë të edukimit seksual në shkollë. Kjo veçanërisht u bë aktuale për shkak të trendit në rritje të dhunës seksuale dhe abuzimit të fëmijëve në të gjithë botën dhe nevojës për t'u mbrojtur.


Të nderuar prindër,

tani që jeni informuar për mënyrën se si do të realizohet pilot programi për edukimin seksual në shkollën tuaj dhe temat që ai i përfshin, ju lutemi t'i ndani mendimet dhe pyetjet tuaja dhe t'ia përcillni ato kujdestarit të klasës/ mësimit të fëmijës tuaj ose t'i dërgoni ato në mënyrë elektronike deri te Byroja për Zhvillimin e Arsimit në **info@brr.gov.mk** ose te HERA në **hera@hera.org.mk**.











МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА - БЮРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES - BYROJA E ZHIVILLIMIT TE ARSIMIT
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE - BUREAU FOR DEVELOPMENT OF EDUCATION



A Member Association of



IPPF
European Network

International
Planned Parenthood
Federation

